



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik: *Njësia Administrative Postrribë*

Data: 12.10.2022

Ora: 13.00

Vendi: *Nj. Administrative Postrribë, Salla e Mbledhjeve*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesëmarrësve 33, nga të cilat 5 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Administratori i Njesisë Z. Vullnet Bushaj dhe anëtari i Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:

Hapja konsultimit nga **Kryetari i njësisë administrative, Vullnet Bushaj**, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim. Ai shton se problematikat janë të shumta dhe gjatë diskutimit shpresojmë që të dalin në pah investimet dhe nevojat kryesore që ka zona. Sipas prioriteteve do të marrim në konsiderate kërkesat tuaja sipas fushave kompetencë të bashkisë.

Avenir Celaj, këshilltar këshilli bashkiak – shpresojmë që për problematikat që kanë banorët të pasqyrohen dhe të gjindet mundësia për t'i zbatuar.,

Erjon Metushi, këshilli bashkiak Shkodër- fokusi sot është marrja e problematikave që keni për sa i përket nevojave në njësinë administrative Postribë dhe hartimit të buxhetit.

Fokusi është të gjejmë menyrën e përbashket për të realizuar nevojat pa ndare kush është Ps dhe Pd por të zgjidhim problemet e komunitetit.

Degjesa është e përqëndruar në disa rubrika dhe funksione të bashkisë prandaj le të ndajmë secili idete për nevojat specifike.

1. Arsimi bazë parashkollor i Mesëm dhe i Përgjithshëm.

Drejtoresha e shkolles, Edlira Aliaj, shkolla e mesme e bashkuar Adem Haxhija – po të shihen dëgjesat që janë bërë vjet dhe ato që kemi këtë vit do të jenë në kontrast. Falenderoj drejtorin Ergys Ivziku dhe kryetarin e njësisë z. Vullnet Bushaj sepse deri më tani jemi shumë të kënaqur për bashkëpunimin dhe kemi gjetur zgjidhje për problematikat që kemi pasur. Kemi roje, kemi sanitare, është bërë lysterja janë vendosur dyert e reja ka ardhur baza materiale dhe i gjithë komuniteti është i kënaqur nga ky bashkëpunim për shkollën Adem Haxhija.

Emergjente për këtë shkollë është fakti që kemi 600 nxënës dhe na duhet një kënd sportiv sepse kemi potenciale të jashtzakonshme nga nxënësit dhe duhet të krijojmë kushtet e favorshme për zhvillimin e edukimit fizik. Kemi rreth 6 dynym pronë në këtë shkollë dhe duhet një investim për këtë shkollë në kënde sportive. Kopshti nuk mund të jetë në të njëjtin ambjent me shkollën dhe duhet të bëhet ndarje nga shkolla me ambjent në vehte.

Gjithashtu është i nevojshëm rrethimi i shkollës.

Po ashtu duhet të vendosen edhe dy bume përpara shkollës për sigurinë e fëmijëve.

Ramazan Qavani, kryeplak Myselim – nuk ka ujë në shkollën Myselim, ka një shpim në këtë shkollë dhe ka nevojë për pompë. S'ka as kënd sportiv në këtë shkollë i cili është i nevojshëm.

Fatmiri, perfaqesues fshati Viles – kemi një shkollë në Vilëz dhe pjesa e jashtme ka nevojë për sovatom apo meremetim. Arsimi në Myselim, ka një ulje të madhe të numrit të nxënësve, kjo për shkak të këndit sportiv dhe kushteve të infrastruktures, mungesa e ujit etj. Problematike mbetet rregjistrimi i fëmijëve në shkollat e tjera dhe ikja nga shkollat e vogla.

Klasat kolektive që krijohen në fshatrat me pak nxënës krijojnë problem dhe shumë fëmijë vijnë dhe rregjistrohen në shkollën Adem Haxhija.

Kryeplaku fshatit Kullaj – shkolla Kullaj është mbyllur, edhe kopshti është investuar nga ana e jonë privatisht dhe jo nga Bashkia. Në shkollën Myselim, kemi pas dy kërkesa për çatinë dhe për lyerjen dhe janë realizuar.

Kryetari i Njësise Administrative Postribë: -Rikonstrukcion dhe Mirëmbajte e Ambjenteve arsimore në Njesinë Adminisatrative Postribë:

- 1 Shkolla e Mesme e Bashkuar Adem Haxhija + Ndërtim këndi sportiv
- 2 Rikonstrukcion Shkolla 9-vjeçare Drisht
- 3 Rikonstrukcion Shkolla 9-vjeçare Domen
- 4 Rikonstrukcion Shkolla Fillore Kullaj

2. - Rrjeti rrugor në Postribë

Është diskutuar edhe vjet per sa i perket rrugëve, është paraqitur kërkesa për rrugën Mes - Myselim – Shkodër, e cila duhet të rikualifikohet totalisht. Po ashtu rruga për Shkodër është e nevojshme për rikualifikim. Gjithashtu rruga Fosej- Gurishta.

Kryetari i fshatit Myselim – Rezervuari i Shtodrit ka nevojë për investim rruge. Bordi i kullimit po bën investim në zonë dhe nuk kemi asnjë informacion. Edhe rruga ura e Mesit deri ne Bardhaj duhet investuar.

Hilmi kapllani - Ura e mesit - bardhaj duhet asfaltim dhe zgjerim i rrugës sepse është bërë vetëm riparim. Ura e mesit e re ka nevojë për ndërhyrje rehabilitimi dhe të shikohet për difekte të vogla që ka. Ndrichimi i rrugës aty deri në Fermentim duhet rishikuar.

Fatmir Lisaj – kemi nevoj për rikualifikim të rrugës Vilëz ,edhe një fadrom të kemi me forcat tona mund ta riparojmë.

Florian Bracaj, banor – është për tu perfunduar loti I -III Mes –Kullaj. Është e nevojshme që të ketë ndërhyrje në qendrat e fshatrave me stola dhe ndrëçim. Duke filluar nga Dragoci tek fshatrat e tjerë, Boks, Kullaj të gjitha duhet të kenë një investim të qëndrave. Rruga e fshatit të ri duhet të ketë rikualifikim të qëndrës, rruga që lidh me xhaminë.

Muhamet Uraj – kryeplak: kërkojmë ndërhyrje në rrugën Mes – Myselim dhe në rrugën Uraj që mund të asfaltohet dhe të ketë edhe ndrëçim. Edhe fshati Drisht ka nevojë edhe për rrugë të brëndshme të fshatit si dhe ndrëçim të fshatit.

Kryetari, fshati Domen - rrugët brenda fshatit janë të shkatërruara dhe ka nevojë për ndërhyrje.

Faz Shabaj, banor – kemi parë edhe disa propozime që janë bërë dhe nga administratori, por rrugët qe jane bërë ndër vite tashmë janë amortizuar. Si p.sh:

1. Rruga Boks –Dragoc- Kullaj ka nevojë për ndërhyrje.
2. Fshati i ri , 3 rrugë të nevojshme për rikualifikim në fshatin e ri Dragoç, fshat i ri Hot.

3. Rrugë prioritare është rruga kryesore, tek Bajraktarët dhe duhet rikualifikuar 500 metra rrugë.
4. Rruga Bibaj duhet të asfaltohet është e nevojshme vetëm shtresa asfaltike.
5. Rruga Domen ka nevojë për riparim.

Fushat sportive, kemi projekte të gatshme për në Dragoç dhe duhet të gjendet mënyra për zbatim.

Aktivitete sportive dhe kulturore nuk ka më në Postribë, dhe duhet të rifillohen të bëhen. (shfaqje aktivitete sportive etj.) për një sërë figurash të njohura që kanë jetuar në Drisht dhe Postribë.

3. PROGRAMI RRJETI RRUGOR RURAL

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore

1. Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara :

- Rruga Qëndër Mes –Kullaj,
- Qëndër Mes-Myselim,
- Qëndër Mes –Dragoç,
- Boks –Rrasek
- Rruga e Domnit
- Mirëmbajtje e rrugëve dytësore të asfaltuara

2. Mirëmbajtje e rrugëve kryesore dhe dytësore me Çakull :

Nr	Emertimi i rrugëve	Gjatesia ml	Gjerësi ml
	Infrastruktura Rrugore		
1	Mirëmbajtje rruga Lagjes Suke, Fshati Kullaj	430	3.5
2	Mirëmbajtje rruga Gurishte fshatin Kullaj	500	3
3	Mirëmbajtje rruga e Vrakes Kullaj	900	3
4	Mirëmbajtje rruga Shkolla e Vjeter ,Fshati Dragoç	550	3.5
5	Mirëmbajtje rruga lagja Çelaj ,Fshati Dragoç	150	3
6	Mirëmbajtje rruga Ksollaxhive ,Fshati Dragoç	450	3.5
7	Mirëmbajtje rruga Fshati i Ri -Dragoç	1700	3.5
8	Mirëmbajtje rruga Xhami Boks -Bibaj ,Fshati Boks	750	3.5
9	Mirëmbajtje rruga e Spahijajve ,Boks	500	3
10	Mirëmbajtje rruga Xhamis në Fshatin e Ri	550	3
11	Mirëmbajtje rruga lagja Uraj ,Fshati Mes	175	3.5
12	Mirëmbajtje rruga Myselim Rezervuar	1000	3
13	Mirëmbajtje rruga Drishte-Vilzë	7000	3.5
14	Mirëmbajtje rruga Omaraj Drishte	1500	3
15	Mirëmbajtje rrugës Domen -Shakot	2.2	3

16	Mirmbajtje rruga Hot i Ri -Dragoç	2150	3
----	-----------------------------------	------	---

3. Rikonstrukcion i rrugëve kryesore dhe dytësore :

Nr	Emertimi I objektit	Gjatesia ml	Gjersia
1	Rikonstrikson rruga Q. Mes -Kullaj (faza IV)	600	4
2	Rikonstrikson rruga Q. Mes -Kullaj (faza V)	600	4
3	Sistemim Asfaltim rruga Lagjes Suke, Fshati Kullaj	430	3
4	Sistemim Asfaltim Rruga Shkolla e Vjeter ,Fshati Dragoç	550	3
5	Sistemim Asfaltim Rruga lagja Çelaj ,Fshati Dragoç	150	3
6	Sistemim Asfaltim Rruga Ksollaxhive ,Fshati Dragoç	450	3
7	Sistemim Asfaltim Rruga Fshati i ri -Dragoç	1700	3
8	Sistemim Asfaltim Rruga Xhami Boks -Bibaj ,Fshati Boks	750	3
9	Rikonstrukcion Rruga Boks -Ura e Rrasekut	1300	4
10	Sistemim Asfaltim rruga Bajraktareve fshati Boksn (ish SMT)	380	3
11	Sistemim Asfaltim Rruga Xhamis Fshati i Ri	550	3
12	Sistemim Asfaltim sheshit ne hyrje te Urs Mesit	70	5
13	Sistemim Asfaltim Rruga lagja Uraj Fshati Mes	175	3
14	Sistemim Asfaltim Rruga Myselim Rezervuar	1000	3
15	Rikonstrikson rruga Q. Mes - Myselim	3000	4
16	Ndertim ure tip Pasarel fshati Prekal	50	1.5
17	Sistemim Asfaltim rrugë ne fshatin Domen	1200	3
18	Sistemim Asfaltim rrugë ne fshatin Omaraj Drishte	2000	3
19	Sistemim Asfaltim rruga Hot i Ri -Dragoç	2150	3

4. Qendrat shëndetsore

Në zonën e Postribës janë në gjendje të mirë, por kemi nevojë për mirëmbajtje, të bëhet verifikim për situatën sepse janë të nevojshme ndërhyrje të lehta:

1. Në Prekal nuk ka qëndër shëndetsore
2. Në Kullaj nuk ka qëndër shëndetsore
3. Në fshatin Mes mungon qëndra shëndetsore dhe është shumë e nevojshme. Ka ambient se ku mund të behet duke rikualifikuar një godine të vjetër në zonë.
4. Edhe në zonen Fshati i ri duke qënë se nr. i popullsisë është rritur është me rëndësi që të kemi qëndër shëndetsore.
5. Qëndër shëndetsore ne fshatin kullaj – ka nevoj për solet – ujë dhe ndriçim
6. Qëndra shëndetsore Mes duhet të jetë ambulancë dhe duhet të rikualifikohet dhe zmadhohet.

Edhe përsa i përket shërbimeve të kujdesit parësor, ka nevojë:

- Ndërtim ambulancë në fshatin Boks
- Ndërtim ambulancë në fshatin Mes
- Ndërtim ambulancë në fshatin Prekal
- Mirëmbajtje e Qendres Shëndetsore ne Qender Mes,Dragoç
- Mirëmbajtje e Ambulancave në fshatrat e tjerë të Njësisë Administrative Postribë.

5. PROGRAMI SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE DHE NDRICIMI RRUGOR

- Mirmbajta e trotuareve në qendër Mes;
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike,
- Mirmbajta e lulishtes dhe hapësirat të gjelbra publike (Qendër Mes)
- Ndrichim i akseve rrugore kryesor dhe dytësore si më poshtë:
- Ndrichim pranë shkollës Mes-Myselim
- Ndrichim në fshatin Kullaj

Nr	Emertimi i objektit	cope
1	Fshati Kullaj rruga Kullaj - Suke Lagja Cekaj	5
2	Fshati Kullaj rruga Kullaj - Suke Lagja Rexhaj,	7
3	Fshati Myselim Rruga Kryesore	10
4	Fshati Mes Rruga Kryesore	12
5	Fshati Dragoç Rruga e Vjeter e ish shkolles	4
6	Fsdhati Boks rruga Spahijajve	8
7	Fshati Dragoç lagja Çelaj	4
8	Fsdhati Boks rruga Bajraktareve	5
9	Fshati Dragoç rruga e Xhamise	6
10	Fshati Mes Rruga dytsore	15
11	Fshati Myselim rrugë dytsore	15
12	Fshati Drishte + Lagja Shmarqe, Dushaj	20
13	Fshati Ura Shtrejte	10
14	Fshati Domen	10
15	Fshati Kullaj rrugë dytsore	15
	Shuma	146

6. PROGRAMI I TRANSPORTI PUBLIK

Vendosje kufizues shpejtësi:

- Rruga Qëndër Mes –Shkolla e Mesme ,
- Rruga Boks- Kullaj.

- Rruga Qënder Mes - Dragoç,
- Rruga në qëndër të fshatit Ura Shtrejtë
- Rruga e Drishtit
- Investim në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët kryesore

7. PROGRAMI MENAXHIMI I MBETJEVE

Kërkesa të Kryetarit të Njësise Administrative Postribë: Frekuenca e pastrimit, koshat në pikat e grumbullimit duhen shtuar në:

1. Mes Dragoc
2. Fshati Dushaj- Drisht
3. Mes Myselim.

Qender Mes, të gjitha inertet që hidhen pranë Urës së Mesit dhe rreth e rrotull saj duhet që të pastrohen. Është pjesë turistike, duhet parë me prioritet, sidomos gjatë sezonit veror sepse ka shumë turistë, duhet parë edhe mundësia e shtimit të një punonjësi pastrimi në këtë pikë. Me shumë rëndësi është edhe vendosja e tabelës sinjalistike për Urën e Mesit.

T'i jepen prioritet pastrimit dhe rikualifikimit të tre zonave atraktive që kemi në Postribë

1. Ura e mesit
2. Shtodri
3. Kalaja e Drishtit

Ka nevojë për vendosje kazane mbeturinash në:

- Në Qendër të fshatit Boks,
- Në rrugën Qender Mes –Dragoç,
- Lagja Dushaj fshati Drishte,
- Lagja Velaj Drishte,
- Në rrugën e Qendër Mes – Mes

Në lidhje me furnizimin me ujë të pishem, fshati Kullaj ka vetëm një orë ujë. Ujësjellësi Drisht dhe Mes - Myselim nuk ka investime. Nuk ka as matesa as rrjet ujësjellësi. Tubat kryesore të vjetër janë brenda avulliave tashmë dhe është e pamundur të administrohen. Fshati i ri është shumë e nevojshme të ketë shtesë të rrjetit të ujsjellësit. Ujësjellësi në Mes Myselim është i gjithë jashtë funksionit dhe vjen ujë i ndotur të cilin nuk mund ta pijmë megjithëse paguajmë. Ka humbje në rrjet dhe duhet të ketë matësa për të gjithë dhe rrjet të rregullt.

Edhe fshati Rasek ka dalje pa matësa dhe bëhet edhe vaditja me këtë ujë. Duhet të merren masa dhe të kontrollohen daljet dhe rrjeti i furnizimit.

Kemi vendosur në dijeni drejtorinë e ujësjellësit dhe presim të marrim përgjigje dhe verifikim për situatën.

Konkretisht:

Ndërtim dhe Rikonstrukcion Ujësjiellësa

- 1 Ndërtim ujësjiellësi Fshati i ri
- 2 Rikonstrukcion Ujësjiellësi Fshati Drishte (rrjeti shpërndarës)
- 3 Rikonstrukcion Ujësjiellësi Fshati - Mes Myselim (rrjeti shpërndarës)
- 4 Rikonstrukcion Ujësjiellësi Fshati Kullaj (rrjeti shpërndarës)
- 5 Ndërtim ujësjiellësi Lagja Omaraj Fshati Drishte

8. PROGRAMI MENAXHIMIT I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Kryetari i fshatit Mes Myselim - Kanali tek Ura e Shtrejtë deri ne Kullaj – Dragoc ka nevojë për ndërhyrje sepse ka derdhje të ujërave të zeza. Asnjë kanal kullues nuk është bërë në zonën tonë .Është një tub vaditje që shërben në Bardhaj, Myselim etj.

Alban Sekja – është planifikuar për tu realizuar këtë vit. Bashkia Shkodër ka një tarifë fikse prej 20 mijë lek/vit për hektar për vaditje. Ndërkohe nuk është arkëtuar asnjë lek. Nuk paguhet asnjë taksë për këto shërbime prandaj kërkesat janë të pambuluara.

Kryetari i fshatit - A mund të thjeshtohet procedura e arkëtimit të pagesave nga ana e bashkisë sepse vijnë për të paguar dhe duke qenë se janë debitorë në vite ka shumë problem për marrjen e të ardhurave.

Alban Sekja - Duhet të ndahet tarifa e ujitjes nga taksa e bashkisë në mënyrë që të jetë e mundur të bëhet vjelja e kësaj takse

Paratë që mblidhen nga tarifa e vaditjes shkojnë direkt për investime dhe mirëmbajtje në vaditje në zonën e caktuar.

PROGRAMI MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

1	Mirëmbajtje, Ndërtim dhe Rikonstrukcion i kanale vadites
2	Mirëmbajtje dhe Ndërtim Kanale vadites sekondare ne fshtrat Kullaj,Dragoç,Boks,Mes,Myselim dhe kanalit kryesor vadites Postribe
3	Nderim kanali vadites sekondare Rruga Dragocit -Fshati i Ri
4	Rikonstrukcion Kanale vadites ne Fhatin Ura Shtrejte
5	Rikonstrukcion Kanale vadites nelagjen Omaraj Drishte

I. Spahia, Këshilltar në Bashkinë Shkodër – vërejmë që kemi shumë problematika të vogla që duhen verifikuar dhe rishikuar.

Banor i njësisë, - Kanalet vaditëse dhe kulluese janë të gjitha pa pastruar, janë të devijuar dhe ka avulli mbi kanalet përkatëse, duhet të bëhet verifikim total i rrjetit të vaditjes. Edhe tek Varrezat ne Dragoc është e nevojshme të bëhet një ndërhyrje janë vetëm 50 metra kanal. Që mbyet të gjithë rrugën.

Albani Sekja – ka një problem për sa i përket parcelizimit të tokës, kanalet me rrjetin vaditës janë të shpërndara dhe në të gjithë pjesën e territorit të bashkisë është një problem me ndërtimet pa leje që janë bërë dhe kanë zënë keto kanale. Është bërë një urdhër për të gjithë administratorët dhe stafin për evidentimin dhe lirimin e këtyre shkeljeve që janë bërë. Shume e rëndësishme është pjesa e pronësise së tokës.

Kerkesa Kryetari i Njesise Administrative Postribe:

9. ADMINISTRIMI I PYJEVE

Problematikat

- Sensibilizimi për ruajtja e pyjeve dhe kullotave nga ana e banoreve për mos demtimin e tyre.
- Ndërgjegjesimi i banoreve dhe dhenia e kontributit në rastet e zjarreve.
- Zgjerimin e strukturës së vullnetarëve civilë në këto raste.

Z.Vullnet Bushaj, - duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë këto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema







BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Postribë

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Vullnet	Bushaj	M				Administrator
2	Erjan	Metushaj	M				Keshilltar
3	Nemis	Leshaj	M				Sek. Keshilltar
4	Aveniz	Gelaj	M				Keshilltar
5	Faz	Sharabaj	M				Banoz
6	Nardir	Spahuj	M				Keshilltar
7	Foliza	Aliaj	F				Dr. Shkolle
8	Blerim	Bushaj	M				X. Fshati
9	Florian	Beqaj	M				Inspektor
10	Aleksandra	Kallaj	F				
11	Ramazan	Çavoci	M				X. Fshati
12	Arbiter	Vehija	M				
13	Fatmir	Shabaj	M				

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Postribë

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Muhamet	Uraj	M				
15	Alfred	Luleta	M				
16	Alban	Sekije	M				
17	Fatmir	Lisaj	M				
18	Figjet	Gelaj	M				
19	Avni	Repaçi	M				
20	Qerim	Milibiti	M				
21	Holim	Shabaj	M				
22	Faik	Hyseni	M				
23	Sait	Shabaj	M				
24	Ilmir	Kapllani	M				
25	Isref	Velija	M				
26	Don	Rrabi	M				

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

